

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës/Direkcija za Obrazovanju i Kulturu

Në bazë të Ligjit për Arsim Parauniversitar në republikën e Kosovës Nr.04/L-032 të datës 29.08.2011.Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138 , udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 , Njoftimit Nr.3/2497 të datës 01.07.2025 të Departamentit të Arsimit Parauniversitar për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e (10) në gjimnaze dhe IAAP, Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS/KORRIK 2026

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË SHKOLLËS PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Shkollën e Mesme Ekonomike në Llabjan për vitin shkollor 2026/2027.

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	30	Ekonomi Nëpunës i Kontabilitetit dhe Tatimeve	30
2	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	30	Ekonomi Nëpunës i Marketingut dhe Shitjes	30
Totali		2	60		60

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e regjistrimit:

Për regjistrim nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2026/2027, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë gjimnaz dhe shkollë profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

-Paraqitja e dokumenteve për shkollë profesionale për vitin shkollor 2026/2027, bëhet më datën **07-08 dhe 09 Korrik 2026**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08:00-16:00**.

-Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën 10.07.2026 (në shkollat ku plotësohet numri).

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **11.07.2026**

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë. Formula për Llogaritjen e pikëve të suksesit është: $(\text{mes.kl.6} + \text{mes.kl.7} + \text{mes.kl.8} + \text{mes.kl.9}) \times 2 = 40$ pikë max. Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2. $(\text{mes. lënda (I)} + \text{mes. lënda (II)} + \text{mes. Lënda(III)} + \text{mes. Lënda (IV)}) \times 2 = 20$ pikë Max, si dhe numri i pikëve nga testi 40 pikë


3. Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale

Ekonomi

- Matematik dhe Informatik 25
- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
- Shkenca shoqërore 25
- Shkencat natyrore 25

$$\begin{aligned} 25 \times 0.8 &= 20 \text{ pikë} \\ 25 \times 0.4 &= 10 \text{ pikë} \\ 25 \times 0.3 &= 7.5 \text{ pikë} \\ 25 \times 0.1 &= 2.5 \text{ pikë} \\ \text{Totali} &= 40 \text{ pikë} \end{aligned}$$

Në Novobërdë
Më, 07.07.2026



Drejtori i DAK-ut
Sinisa Dimic